



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

URDHËR

Nr. 778, datë 28/04/2015

**“PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR ZBATIMIN E SË
DREJTËS SË INFORMIMIT NDAJ PUBLIKUT”**

Në zbatim të neneve 7, 8, 10, 19 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Dhënien e informacionit me kërkesë, i cili bëhet me kërkesë të palës së interesuar pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE). Kërkesa bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike duke paraqitur qartë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.
2. Në çdo rast, kur kërkesa paraqitet dorazi apo nëpërmjet shërbimit postar duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 4 të nenit 11 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” ku përfshihen: emri dhe mbiemri i kërkuarit; adresa postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; përshkrimi i informacionit që kërkohet; formati në të cilin preferohet informacioni dhe çdo e dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
3. Pas regjistrimit dhe protokollimit kërkesa i paraqitet për vlerësim dhe miratim Kryetarit të AKSHE-së.
4. Nëse konstatohet se kërkesa është në përputhje me kërkesat ligjore, Kryetari i AKSHE-së autorizon koordinatoren për të drejtën e informimit apo nënpunësin përgjegjës për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesës së paraqitur.
5. Dokumentacioni apo informacioni i kërkuar, I jepet palës së interesuar Brenda afateve të përcaktuara në nenin 15 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj.

Afati 10 ditor mund të zgjatet jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtëme:

- a) Nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta voluminoze;
- b) Nevoja për ti shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e Autoritetit;
- c) Nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuesit.

Në çdo rast, mos trajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.


Kur AKSHE-ja ia dërgon kërkesën për informim një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

- 6. Koordinator/Koordinatorja për të drejtën e informimit kryen njoftimet paraprahe për kërkuesin e informacionit në rastet e mëposhtëme:
 - a) Në qoftë se konstatohet se trajtimi i një kërkesë për informim ka kosto të lartë ose trajtimi i saj kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1 të nenit 14 dhe në nenin 7 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*", AKSHE-ja njofton menjëherë kërkuesin dhe i propozon mundësinë e ndryshimit të kërkesës së tij.
 - b) Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, AKSHE-ja i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni.
 - c) Pas marrjes së kërkesës për informim, AKSHE-ja llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin. Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Financave.
- 7. Krijimin e një regjistri të veçantë elektronik, për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit, bashkëlidhur këtij urdhëri(Shtojca B).
- 8. Caktimin e Z. Ogren BALLUKU Koordinator për të drejtën e informimit në AKSHE, në përputhje me pikën 6 të nenit 2 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*". Kompetencat e Koordinatorit/es, në përputhje me nenin 10 të ligjit të sipërcituar janë si mëposhtë:
 - a) T' i mundësojë çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacion publik, sipas ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*", duke u konsultuar me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij;
 - b) T' i krijojë, mbajë, publikojë dhe përditësojë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*";
 - c) Të bashkërendojë punën për plotësimin e kërkesave për informacione Brenda afatave dhe sipas mënyrës të parashikuar në ligjin Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*";
 - ç) Të regjistrojë kërkesat për informacion dhe të caktojë një numër rendor për secilin prej tyre;

- d) Të dërgojë kërkesën për informim te një autoritet tjetër public, Brenda afataeve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk zotëron informacionin e kërkuar;
 - dh) Të verifikojë rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 13 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*";
 - e) Të kryejë njoftimet paraprake, sipas neneve 14, 15 të ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*", si dhe komunikon me kërkuuesin, sipas nevojës, për trajtimin e kërkesës për informacion publik.
9. Rregullimin e procedurave për vënien në dispozicion të kopjes së dokumentit zyrtar "Deklaratë e Interesave Privatë" kryhet me urdhër të Kryetarit të AKSHE-së në përputhje me me nenin 34 të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë".
10. Ngarkohet Koordinator/ja për të drejtën e informimit dhe të gjithë punonjësit e institucionit për zbatimin e këtij urdhëri.
11. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Engjëlush BEKTESHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

FORMATI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE NË AKSHE

Shtojca B

Nr. Rendor (1)	Data e Regjistrimit të Kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i Kërkesës (5)	Tarifa (6)
1.	Data/Muji/ Viti	(Përmban edhe përmbledhje të kërkesës)	(Përmban edhe përmbledhje të përgjigjes)	Pranuar/refuzuar/ pjesërisht pranuar	Pa pagesë/ Me pagesë

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo 3(tre) muaj.

- (1) Evidentohet Kronologjia e kërkesave
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesave
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.
(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")
- (5) Ndhmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.